

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo Rada i Socijalne Zastine. - Ministry of Labour and Social Welfare

Prishtinë, Datë: 04.05.2018

Në mbështetje Neni 8 dhe Neni 16 paragraf 3 të Rregullores MF-Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe Thirrjes Publike të datës 05 shkurt 2018 për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve të licencuara nga MPMS-ja në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, bazuar në Vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të MPMS-së me Nr. 143 të datës 30.03.2018 për themelimin e Komisionit Vlerësues të aplikacioneve, Komisioni Vlerësues nxjerr:

V E N D I M

1. Në përputhje me detyrat dhe afatet e komisionit të përcaktuara në vendimin e lartë përmendur dhe duke u bazuar në Thirrjen Publike të datës 05 shkurt 2018, Komisioni Vlerësues ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjithë dokumentacionin përkatës, të dërguar nga OJQ-të, ku sipas kriterëve Komisioni Vlerësues ka shpallur fituesit për subvencionim këto OJQ aplikuese:

Nr.	Organizata fituese	Titulli i Projektit	Pikët e fituara
1	„Qendra për jetë të pavarur“-Pejë	„Zhvillimi i pavarësisimit për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara mendore dhe këshillimi i familjeve me persona me aftësi të kufizuara mendore“	79.20
2	„SOS fshatrat e fëmijëve - KOSOVË“-Prishtinë	„Asnjë fëmijë të mos rritet I vetëm,,	79.00
3	„Shtëpia e Sigurt“-Gjakovë	„Përmirësimi i shërbimeve të strehimit, rehabilitimit dhe riintegrimi i grave dhe fëmijëve „viktima të dhunës në familje“	77.80
4	„Qendra e kujdesit ditor -PEMA“-Prishtinë	„Ofrimi i shërbimeve sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara në qendrat e kujdesit ditor në Prizren dhe Ferizaj“	77.20
5	„NËNË TEREZA“-Prishtinë	„Për një pleqëri të dinjitetshme“	76.80

6	„Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së fëmijëve-HENDIKOS"-Prishtinë	„Ofrimi i shërbimeve cilësore për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuar në regionin e Prishtinës"	76.80
7	„Shpresa dhe shtëpitë e fëmijëve-KOSOVË"-Prishtinë	„Ofrimi i shërbimeve rezidenciale për fëmijët në nevojë për mbrojtje sociale"	76.80
8	„HUMANITETT"-Rahovec	„Shërbimet familjare dhe ato shtëpiake për fëmijët dhe të rriturin në nevojë"	76.20
9	„Qendra për strehimin e grave dhe fëmijëve „-Prizren	„Ofrimi i shërbimeve strehuese për viktimat e dhunës në familje në kuadër të strehimores"	75.60
10	„HANDIKOS"-Pejë	„Shërbime cilësore për personat me aftësi të kufizuar"	74.80
11	„Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve-Shtëpia Ime"-Ferizaj	„Strehimi dhe kujdesi për gra,vajza dhe fëmijë viktime të të gjitha formave të dhunës,,	74.00
12	„Qendra për mbrojtjen e viktimave dhe parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore"-Prishtinë	„Strehim dhe rehabilitim për viktime të trafikimit dhe viktime potenciale të trafikimit,fëmijë dhe të rritur"	74.00
13	„Qendra për Mirëqenien e Gruas"-Pejë	„Strehim ,mbrojtje dhe përkrahje për viktimat e dhunës në familje"	72.20
14	„Qendra për mbrojtjen dhe rahabilitimin e grave dhe fëmijëve-LIRIA"-Gjilan	„Strehim i sigurt për gratë dhe fëmijët ,viktime të dhunës në familje"	72.00
15	„HANDIKOS"-Suharekë	„Përmirësimi i jetës së fëmijëve dhe të rriturve me nevoja të veqanta"	71.80
16	„Organizata për fëmijët pa kujdes prindëror "-Prishtinë	„Fuqizimi i srehimit familjar në mbrojtje të fëmijëve pa përkujdes prinderor,të braktisur,të keqtrajtuar dhe të lënë pas dore,,	71.60
17	„Shoqata e pavarur e gruas -HAREJA" Rahovec	„Edhe ne jemi pjesë e Shoqërisë"	71.40
18	„Qendra për mbrojtjen e gruas dhe fëmijës-RABA VOCA-Mitovicë	„ Strehimi ,rahabilitimi dhe riintegrimi i viktimave të dhunës"	71.20
19	„Duart plotë mëshirë"-Pejë	„Shërbime sociale për fëmijë me ngecje të vogël mendore,të moshuarit dhe të sëmurët"	63.40
20	„Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve"-Prishtinë	„Mbrojtje,strehim dhe fuqizim per viktimat e dhunës në familje"	62.20
21	„AUTIZMI,-Prishtinë	„Mbështetja e shërbimeve për trajtimin e fëmijëve me autizëm"	60.20

2. Në përputhje me detyrat dhe afatet e komisionit si dhe duke u bazuar në Thirrjen Publike të datës 05 shkurt 2018, Komisioni Vlerësues ka vlerësuar se OJQ-të aplikuese të renditura më poshtë në bazë të dokumentacionit përkatës të dërguar, nuk kanë plotësuar kriteret për t'u shpallur fitues për subvencionim:

Nr.	Organizatat e refuzuara	Titulli i Projektit
1	Centar za Mir i Toleranciju-Prishtina	Shërbimet këshilluese nga OJQ, për të mbrojtur gratë dhe fëmijët nga trafikimi dhe dhuna me bazë gjinore
2	Healthy life	Këshillime për viktimat e dhunës në familje
3	Autizmi Flet	Zhvillimi i kapaciteteve të organizatës
4	Doën Syndrom Kosova	Mbështetë zhvillimin e potencialit tim
5	Aociacioni i Kriminalisteve të Kosovës	Paralajmërimi i hershëm dhe menaxhimi i problemeve të familjeve dhe fëmijëve të pa strehë
6	Shoqata Kosovare e të Shurdhëve	Ofrimi i shërbimeve në gjuhën e shenjave nga institucionet publike për të gjithë qytetarët e shurdhër në Republikën e Kosovës
7	Shoqata e të Verbërve të Kosovës	Shërbimet në komunitet

ARSYETIM

- a. Komisioni Vlerësues brenda afatit të përcaktuar me Planin e Veprimit ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni të dërguar nga OJQ-të aplikuese. Në fazën e parë është bërë vlerësimi, përkatësisht kontrolli administrativ i secilit aplikacion, për të parë nëse plotësojnë kushtet formale dhe administrative për të vazhduar më tutje me vlerësim të aplikacioneve, sipas kriterëve të vlerësimit të përcaktuara në Udhëzuesin për Aplikant.
- b. Nga gjithsejt njëzet e tetë (28) aplikacione të pranuar, vetëm njëzet e një (21) prej tyre i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara dhe është vazhduar më tutje për vlerësim. Kurse shtatë (7) aplikacione nuk i kanë plotësuar kriteret për t'u proceduar më tutje për vlerësim, meqë nuk kanë qenë organizata të licencuara nga MPMS për të ofruar shërbime sociale, sikur është përcaktuar në Thirrjen Publike.
- c. Në bazë të detyrave të Komisionit dhe sipas Planit të Veprimit, Komisioni Vlerësues ka shqyrtuar njëzet e një (21) aplikacionet që i kanë plotësuar kriteret dhe ka vendosur për mbështetje financiare të projekteve. Renditja organizatave fituese në bazë të pikëve të fituara është bërë në tabelën që gjenden në pikën 1 të këtij vendimi.
- d. Në bazë të detyrave të Komisionit dhe sipas Planit të Veprimit, Komisioni Vlerësues nuk ka vendosur t'i shqyrtoj më tutje aplikacionet për shtatë (7) organizata aplikuese që nuk i kanë plotësuar kriteret, meqë nuk kanë qenë të licencuara. Organizatat aplikuese në kuadër të Thirrjes Publike e që nuk janë vlerësuar për t'u mbështetur financiarisht janë paraqitur në tabelë në pikën 2 të këtij vendimi.

- e. OJQ-ët të cilat kanë kaluar fazën e parë të vlerësimit, por të cilat nuk i kanë bashkëngjitur të gjithë dokumentet e kërkuara sipas Thirtjes Publike dhe Udhëzuesit për Aplikant, Komisioni Vlerësues i ka kontaktuar të gjitha ato organizata, duke i'u dhënë një afat shtesë për të sjellur dokumentet e kërkuara ashtu sikur e përcakton edhe Rregullorja mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, në nenin 16, paragrafi 1.4.
- f. Pas përfundimit të kësaj faze të vlerësimit, Komisioni Vlerësues në bazë të detyrave të saj të përcaktuara në nenin 20, paragrafi 2, të Rregullores mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, ka kërkuar nga OJQ-të të cilat janë përfshirë në listën paraprake të përfituesëve, që të rishikojnë projekt-buxhetet e propozuara.

Në vlerësimin e të gjitha aplikacioneve dhe duke u bazuar në afatet kohore për vlerësim, shpallje të listës paraprake, njoftimin e aplikantëve dhe për publikimin e listës përfundimtare të organizatave fituese, Komisioni Vlerësues është bazuar në Rregulloren mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Rregulloren e Punës së Komisionit, Planin e Veprimit dhe kriteret e përcaktuara në Thirrjen Publike dhe Udhëzuesin për Aplikant.

Kriteret përcaktuara në Udhëzuesin për Aplikant, kanë qenë të karakterit (formal) të përgjithshëm dhe të veçanta.

Kriteret e përgjithshme:

- OJQ-të aplikuese të jenë të regjistruara në Ministrinë e Administratës Publike (për të dëshmuar këtë kërkesë, OJQ-ja aplikuese duhet të dërgoj kopjen e certifikatës së regjistrimit me rastin e aplikimit;
- OJQ-të aplikuese të jenë të licencuara në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (për të dëshmuar këtë kërkesë, OJQ-ja aplikuese duhet të dëshmojë duke dorëzuar kopjen e licencës;
- Të jetë e pajisur me Numër Fiskal, të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës. Me rastin e aplikimit OJQ-ja duhet të dëshmojë këtë kërkesë përmes kopjes së certifikatës së numrit fiskal;
- OJQ-të aplikuese duhet të kenë kryer të gjitha detyrimet tatimore ndaj ATK-së. Ndonëse mund të ketë detyrime të pashlyera në momentin e aplikimit, OJQ-ja që përfiton nga fondet publike para nënshkrimit të kontratës duhet të dëshmojë se ose ka kryer obligimet tatimore ose ka arritur ndonjë marrëveshje me ATK-në për kryerjen e tyre në të ardhmen. Ekzistenca e borxheve dhe obligimeve tjera të pashlyera nuk guxon të ndikoi në implementimin e projektit, prandaj, zgjidhja e çfarëdo detyrimi të tillë para nënshkrimit të kontratës është e domosdoshme;
- OJQ-ja aplikuese nuk duhet të ketë pranuar mjete financiare për realizimin e të njëjtave aktivitete në vitin përkatës fiskal. Prandaj, me rastin e aplikimit kërkohet një deklaratë e cila e shmangë financimin e dyfishtë për aktivitetet e njëjta;
- Të kenë dorëzuar një projekt propozim sipas formularit të aplikacionit të projektit/programit së bashku me formularin e propozim buxhetit.

Kriteret e veçanta:




- Të dorëzojnë brenda afatit të thirrjes projekt propozimin i cili ndër të tjera përmban të dhënat për qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të dhënat tjera sipas formularit përkatës të përcaktuar sipas thirrjes publike;
- Projekt propozimi të jetë i shoqëruar me një propozim buxhet, sipas formatit të përcaktuar sipas Thirrjes Publike dhe Manualit për zbatimin e kësaj Rregulloreje;
- Të dorëzojnë të dhëna për personelin kyq, duke specifikuar detyrat e tyre, siguruar CV-të e tyre së bashku me një deklaratë pranimi nga ana e tyre se do të punojnë për projektin/programin, në rast të përfitimit të mbështetjes financiare, nëse kjo është e domosdoshme sipas thirrjes;
- Të sigurojnë dëshmitë e duhura për projektet për të cilat kërkohet bashkëfinancim, nëse është e aplikueshme;
- Të dëshmojnë se kanë përvojë në realizimin e projekteve/ programeve të ngjashme duke siguruar dëshmi të realizimit të projekteve të ngjashme në të kaluarën, nëse kjo është e domosdoshme sipas thirrjes përkatëse;
- Të paraqesin leje/licencë për ushtrimin e veprimtarisë në rastet kur me legjislacionin në fuqi ushtrimi i një veprimtarie të tillë mund të kryhet vetëm me leje/licencë nga autoritetet publike.

Duke u bazuar në këto kritere, Komisioni Vlerësues ka identifikuar që njëzet e një (21) aplikacionet e vlerësuara plotësojnë kriteret për të kualifikuar si përfituese nga subvencionet e MPMS-së, ndërsa shtatë (7) aplikacione nuk i plotësojnë kriteret formale për t'u kualifikuar si përfituese nga subvencionet e MPMS-së.

Udhëzim Juridik: Kundër këtij Vendimi palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në afat prej 5 ditësh nga data e shpalljes së rezultateve përfundimtare në ueb faqe të MPMS-së.

Ankesat i paraqiten Komisionit të Ankesave, përmes arkivës së MPMS-së.

Komisioni Vlerësues i projekt propozimeve të dorëzuara nga OJQ-të aplikuese:

1. Zemrie Limaj-Kryesuese e Komisionit 
2. Mentor Morina-Anëtar i Komisionit 
3. Lule Maloku-Anëtare e Komisionit 
4. Vjosa Shehu-Anëtare e Komisionit 
5. Fitim Sadiku-Anëtar i Komisionit 